E-Buletini Mujor në Fushën Antikorrupsion

Nr. 65 - tetor, 2026

Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit është struktura teknike, në nivel qendror, përgjegjëse për hartimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kundër korrupsionit në Shqipëri.

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton dhe ndjek kuadrin strategjik kundër korrupsionit, pregatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të integritetit, politikat dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe të edukimit kundër korrupsionit. Është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve publike që kryejnë abuzime me detyrën. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon mekanizmin e referimit, të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Buletini elektronik është një mjet komunikimi që synon të informojë aktivitetet kryesore, iniciativat dhe zhvillimet në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke ofruar një përmbledhje mujore të punës së institucionit.

Aktivitetet përgjatë muajit tetor, 2026

Procesi i Berlinit bashkon në Tiranë funksionarë politikë, ekspertë të administratës dhe të fushës antikorrupsion







15.10.2026: Në kuadër të angazhimeve dhe bashkërendimeve të marra nga vendet e përfshira në forumin e Procesit të Berlinit, u zhvillua në Tiranë aktiviteti rajonal me temë *"Nga bashkëpunimi rajonal te veprimi i përbashkët: Forcimi i integritetit dhe luftës kundër korrupsionit në Evropën Juglindore"*, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë politik, institucioneve antikorrupsion, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile nga vendet e rajonit. Forumi rajonal u hap nga Ministri për Administratën Publike , znj. Adea Pirdeni. Rëndësia e forcimit të integritetit, bashkëpunimit rajonal dhe avancimit të përpjekjeve të përbashkëta në luftën kundër korrupsionit si dhe adaptimi i administratës së vendeve të rajonit për të ndjekur masa dhe veprime u promovuan nga Ministri Pirdeni në mesazhin e përcjellë prej saj. Forumi u organizua në formën e disa paneleve me qëllim ofrimin e dialogut të nivelit të lartë politikë (1) dhe, dialogun ndërinstitucional dhe grupeve të ndryshme të interesit. Forumi me pjesëmarrje përfaqësues të nivelit politik u ndal kryesisht ne diskutime mbi pavarësinë dhe efektivitetin e sistemeve të integritetit, si edhe përpjekjet për formësimin e të ardhmes së integritetit dhe qeverisjes së mirë. Ndërkohë që qasja e diskutimeve teknike ishin kryesisht në funksion të ndërveprimit midis administratave vendore, shoqërisë civile dhe biznesit, si dhe përdorimin e mjeteve inovative të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale. Shqipëria u përfaqësua në këtë forum nga staf politikë dhe teknikë, duke adresur përafrimin e reformave antikorrupsion të vendit me standardet dhe prioritetet e Bashkimit Evropian. Shqipëria ndau gjithashtu nismat në zbatim të ntegritetit në nivel vendor, pjesëmarrje qytetare dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, shoqërisë civile dhe sektorit privat, në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Forumi rajonal i Tiranës riafirmoi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe angazhimit të përbashkët të institucioneve të Ballkanit Perëndimor për forcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, duke jetëzuar Procesin e Berlinit në nisma institucionale.

Zhvillohet forum për dialog rajonal për parandalimin e korrupsionit dhe vlerësimin e risqeve







1.10.2026: U zhvillua në Shkup, Konferenca Rajonale për Parandalimin e Korrupsionit dhe Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit në Ballkanin Perëndimor, e organizuar nga Zyra Shtetërore e Auditimit e Maqedonisë së Veriut dhe Instituti i Financave Publike dhe Kontabilitetit (CIPFA). Përfaqësues të institucioneve publike, strukturave antikorrupsion dhe organizatave ndërkombëtare diskutuar mbi raste e praktika verifikimi dhe kontrolli të rasteve të korrupsionit në administratën publike. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit iu bashkua forumit me stafin drejtues teknikë, përgjegjës për hetimin dhe verifikimin administrativë, duke ndarë praktika pune konkrete. Gjatë forumit, vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të institucioneve antikorrupsion në zhvillimin e politikave parandaluese, forcimit të koordinimit ndërinstitucional, transparencës në prokurimet publike dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e integritetit dhe llogaridhënies. Diskutimet u përqendruan gjithashtu në shkëmbimin e përvojave kombëtare dhe identifikimin e sfidave të përbashkëta me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor. Përmes sesioneve teknike dhe diskutimeve ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrëse, u trajtuan qasjet praktike për vlerësimin e riskut të korrupsionit, hartimin e planeve të integritetit dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal, duke shqyrtuar mundësitë për zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimin e mëtejshëm teknik. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijon të adresojë nëpërmjet pjesëmarrjes së saj në aktivitete rajonale, angazhimin institucional për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimin e ekspertizës dhe promovimin e qasjeve të qëndrueshme në parandalimin e korrupsionit, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Tetor 2026; hetimi administrativ kundër korrupsionit procedon 6 raporte përfundimtare me 21 rekomandime

1-30.10.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijoi me ndjekjen e rasteve të dyshuara të korrupsionit, me verifikime dhe hetime administrative, duke trajtuar ankesat dhe denoncimet e administruara direkt nga struktura e hetimit administrativë pranë saj si edhe nga Koordinatorët Kundër Korrupsionit. Verifikimet prëgjatë këtij muaji janë fokusuar në raste që lidhen me mosrespektimin e procedurave administrative, tejkalimin ose mosushtrimin e kompetencave, mungesën e transparencës në vendimmarrje, vonesat në ofrimin e shërbimeve publike dhe problematika të tjera që cenojnë integritetin e administratës publike. Pas analizës së dokumentacionit dhe provave të administruara, si dhe vlerësimit të natyrës së shkeljeve të konstatuara, ndikimit të tyre në funksionimin e institucionit dhe përgjegjësisë individuale të punonjësve të përfshirë, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka konkluduar me 6 raporte përfundimtare për DVASHK Vlorë, DVASHK Berat, DVASHK Fier dhe AKU. Në funksion të rolit të saj parandalues, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit ka dhënë rekomandime për përmirësimin e praktikave institucionale dhe forcimin e mekanizmave të integritetit. Në raportet përfundimtare të muajit tetor, janë propozuar gjithsej 21 rekomandime, nga të cilat në 16 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete, dhe në 5 raste adresojnë çështje me natyrë organizative, duke synuar forcimin e mekanizmave të menaxhimit të brendshëm dhe rritjen e efektivitetit institucional.

Raportoni raste të korrupsionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në: koordinatori.ak@dpak.gov.al

ReSPA mbledh Komunitetin e Ekspertizës për integritetin





21-22.10.2026: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit mori pjesë në workshop-in e komunitetit të ekspertizës për integritetin në sektorin publik, e organizuar në Tiranë, nga Regional School of Public Administration (ReSPA). Aktiviteti u zhvillua në kuadër të nismës për identifikimin e çështjeve dhe nevojave për kapacitete teknike profesionale, në funksion të promovimit të sjelljeve etike dhe parandalimit të korrupsionit. Komuniti i ekspertizës së ReSPA mundëson institucionalizimin e mekanizmave të integritetit në sektorin publik, dhe është gjithashtu një mekanizëm operacional për shkëmbimin e informacionit në rajon sa i takon praktikave më të mira, zbatimit të trajnimeve të integritetit, si dhe koordinimit të trajnimeve "*pilot*" në institucionet respektive të administratave të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në sesionin e organizuar me prezantimet e vendeve pjesëmarrëse, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit evidentoi nevojat për përmirësimin e metodave të ndërgjegjësimit mbi zbatimin e politikave të integritetit nga nëpunësit e administratës publike.